



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR  
TIRANË**

**NJOFTIM**

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr.7, datë 26.05.2021, në ngarkim të shtetasit Anton (Pashuk) GJINAJ (Gjini), i biri i Ndue dhe i Prendë, i datëlindjes 08.04.1966, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë.

Nga aktet e administruara rezulton se me vendimin Nr.9 të vitit 2010, të Gjykatës Provinciale të Alicante, me seli në Elce, Spanjë është deklaruar fajtor i pandehuri Pashuk Gjini dhe është dënuar me 8 vjet e 9 muaj burgim për vepren penale të trafikimit të lëndëve narkotike në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Nga verifikimet e kryera nga ana e policisë gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithëshme të Policisë së Shtetit rezulton se shtetasi Pashuk Gjini me datë 17.02.2011, ka bërë ndërrimin e emrit nga “Pashuk Gjini” në “Anton Gjinaj”.

Nga analiza e fakteve dhe e dokumentacionit të administruar përse i përket pasurive të shtetasit Anton (Pashuk) GJINAJ (Gjini) dhe familjarëve të tij, rezulton se kanë një nivel të pajustificuar ekonomik dhe dyshohet se këto pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, t’i kenë fituar si rezultat i veprimtarisë së tij kriminale që ai ka zhvilluar në Shqipëri dhe Spanjë.

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar bazuar në nenet 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” (i ndryshuar) është paraqitur kërkesë për sekuestrimin e pasurive të shtetsit Anton (Pashuk) GJINAJ (Gjini).

Nga ana e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr.22 datë 27.07.2022, është vendosur :

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

**II. Sekuestrimin e pasurive të subjektit nën hetim pasuror Anton (Pashuk) Gjinaj (Gjini), si dhe të personave të lidhur si më poshtë:**

- 1. Shoqëria “ALESIO – 2014” shpk**, me NIPT Nr. L41713003M, me datë themelimi 08.05.2014 dhe datë regjistrimi 13.05.2014, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”.

2. Shoqëria “**DEIZI - M**” shpk, me NIPT Nr. L82212004G, me datë themelimi 22.09.2018 dhe datë regjistrimi 12.10.2018, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”.
3. Shoqëria “**POLYSTYRENE (EPS) MANUFACTURER**” shpk, me NIPT Nr. L81811014B, me datë themelimi 04.06.2018 dhe datë regjistrimi 11.06.2018, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”.
4. Shoqëria “**FORALB ALABASTER**” shpk, me NIPT Nr. J62903844I, me datë themelimi 04.11.1994 dhe datë regjistrimi 08.11.1994, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”.
5. Shoqëria “**XYZ 08**” shpk, me NIPT Nr. K92110004Q, me datë themelimi 18.02.2008 dhe datë regjistrimi 10.09.2008, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”.
6. Shoqëria “**GARDEN RESIDENCE TURDIU**” shpk, me NIPT Nr. L91425024V, me datë themelimi 21.02.2019 dhe datë regjistrimi 25.02.2019, me formë ligjore të shoqërisë “Shpk”.
7. Pasuri me sipërfaqe totale 1 290 m<sup>2</sup>, e llojit truall nga e cila 246 m<sup>2</sup> ndërtesë, me adresë Tiranë.
8. Pasuri me sipërfaqe totale 120 m<sup>2</sup>, e llojit apartament, me adresë, Laprakë, Tiranë.
9. Pasuri me sipërfaqe totale 301.5 m<sup>2</sup>, e llojit truall nga e cila 246 m<sup>2</sup> ndërtesë, me adresë Tiranë.
10. Pasuri me sipërfaqe totale 1 680 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
11. Pasuri me sipërfaqe totale 6 530 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Tiranë.
12. Pasuri me sipërfaqe totale 5 560 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
13. Pasuri me sipërfaqe totale 3 930 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
14. Pasuri me sipërfaqe totale 1 670 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
15. Pasuri me sipërfaqe totale 480 m<sup>2</sup>, e llojit truall, me adresë Tiranë.
16. Pasuri me sipërfaqe totale 84.4 m<sup>2</sup>, e llojit ndërtesë, me adresë Tiranë.
17. Pasuri me sipërfaqe totale 57.8 m<sup>2</sup>, e llojit ndërtesë, me adresë Tiranë.
18. Pasuri me sipërfaqe totale 2 092.4 m<sup>2</sup>, e llojit truall, me adresë Lundër, Tiranë.
19. Pasuri me sipërfaqe totale 700 m<sup>2</sup>, e llojit arë, me adresë Marikaj, Tiranë.
20. Automjet i tipit autoveturë, e markës “Mercedes-Benz”, modeli CLS320CDI.
21. Automjet i tipit autoveturë, e markës “Mercedes-Benz”, modeli G 63 AMG.
22. Automjet i tipit autoveturë, e markës “Mercedes-Benz”, modeli GLE 400 d 4MATIC Coupe.
23. Automjet i tipit autoveturë, e markës “VOLKSWAGEN”, modeli “GOLF”.

Sot me datë 28.07.2022 nga strukturat e Policisë së Shtetit u bë ekzekutimi i vendimit të sekuestros të dhënë nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.